



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:129073  
Datë: 03.10.2024  
Numri i dokumentit: 06246036

**K.DH.Shk II.nr.1283/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.”, me seli në Prishtinë, Rr. “Robert Doll”, nr.99, kundër debitorëve: 1. N.SH.T. “Berisha Impex”, me numër të regjistrimit të biznesit 70329318 me adresë në ..., Istog, me përfaqësues F.B., 2. F.B., me numër personal ..., me adresë në ... Istog, 3. B.B., me numër personal ..., me adresë në ... Istog, me përfaqësues të përkohshëm N.B., 4. R.B., me numër personal ... me adresë në ..., Istog dhe 5. F.B.1., me numër personal ..., me adresë në ..., Istog, me përfaqësues të përkohshëm M.B., me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2483/22 të datës 24.05.2024, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorëve F.B. dhe R.B. ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2483/22 të datës 24.05.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2483/22 të datës 24.05.2024, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorëve N.SH.T. “Berisha – Impex”, F.B. dhe R.B.. i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.196/22 të datës 29.04.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku II. SHFUQIZOHET Urdhrit Përmbarimor P.nr.196/22 i datës 29.04.2022 lidhur me borxhin prej 1,376.24€ (një mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e

njëzet e katër cent) në emër të shfrytëzimit të Visa Biznes kredit kartelës të datës 14.11.2019. III. SHFUQIZOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.196/22 i datës 29.04.2022 mbi bazën e Shtojcës I të Marrëveshjes mbi Pengun. IV. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.196/22 i datës 29.04.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku mbi bazën e Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 561/2018 dhe Ref.nr. 362/2018 e datës 06.12.2018 e hartuar nga noteri Arësim Avdijaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anulohet vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2483/22 të datës 24.05.2024, dhe të bëjë vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditori nëpërmjet përgjigjes në ankesë tha theksuar se Aktvendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është i drejtë dhe i bazuar andaj, Dhomave të Shkallës së Dytë u ka propozuar që ankesën e debitorëve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

- **Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.” (RBKO) ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.196/22 të datës 29.04.2022, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.201716762, Marrëveshjes mbi lëshimin e Visa Biznes kredit kartelës e datës 14.11.2019, Shtojcës I të Marrëveshjes mbi Pengun dhe Konfirmimit të regjistrimit R-20181211-293 dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP-nr.rend:561/2018 dhe Aktvendimit për regjistrimin e hipotekës Nr.117/22018/H, duke obliguar debitorët që të paguajnë shumën prej 73,339.84€ dhe atë 71,963.6€ në bazë të Marrëveshjes së Kredisë dhe 1,376.24€ në emër të shfrytëzimit të Visa Biznes kredit kartelës të gjitha në afat prej 7 ditësh bashkë me kamatën ligjore, përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare dhe sekuestrimit të sendeve të lëna peng dhe shitjes ë paluajtshmërive të lëna në hipotekë..

Debitorët brenda afatit ligjor, përmes prapësimit kanë kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin për lejimin e përmbartimit. Tutje ka theksuar se për shkak të rrethanave të krijuara debitorëve u është pamundësuar pagesa e borxhit, respektivisht si pasojë e pandemisë Covid 19 dy debitorë Barllo dhe F.B.1., andaj bazuar në këtë rrethanë debitorët N.SH.T. “Berisha – Impex”, F.B. dhe R.B. i kanë propozuar gjykatës që prapësimin e tyre ta aprovoj si të bazuar dhe të refuzoj urdhrin duke u mundësuar debitorëve që me kreditorin të arrijnë marrëveshje jashtëgjyqësore.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorëve si të pabazuara, pasi që të njëjtat nuk janë mbështetur me asnjë provë të vetme duke

e cilësuar kështu prapësimin në kundërshtim me dispozita ligjore të LPP-së. Tutje ka theksuar se propozimi për përbarim i plotëson të gjitha kushtet ligjore pasi që i njëjti është iniciuar në bazë të dokumentit përbarimorë dhe në të janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara me këtë ligj. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin si në dispozitiv.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata vendosi të shfuqizoj Urdhrin Përbarimor P.nr. P.nr.196/22 të datës 29.04.2022, lidhur me borxhin prej 1,376.24€ sipas Marrëveshjes mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës, pasi që gjeti se nuk janë plotësuar kushtet për lejimin e përbarimit. Gjykata vendosi të lë në fuqi Urdhrin Përbarimor P.nr.196/22 të datës 29.04.2022 të lejuar nga Përbaruesi Privat Blerim Baloku, sa i përket borxhit prej 73,339.84€ sipas Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.201716762 mbi bazën e dokumentit përbarimorë Kontratës për Hipotekën LRP.nr. 561/2018 dhe Ref.nr. 362/2018 e datës 06.12.2018 e hartuar nga noteri Arësim Avdijaj dhe Aktvendimit për regjistrimin e hipotekës Nr.117/22018/H.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përbarimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përbarimin sipas dokumentit të përbarimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 dhe me nenin 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përbarimore, Ligjit për Procedurën Përbarimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore ku në mesin e dokumenteve përbarimore në bazë të cilave organi përbarues mund të caktoj përbarimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Gjykata e Shkallës së Parë me të drejtë ka vlerësuar se dokumenti përbarimorë mbi bazën e së cilit është lejuar përbarimi respektivisht Marrëveshja mbi Kredinë Nr.201716762, dhe Shtojca I e Marrëveshjes mbi Pengun nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të përbarueshme në përputhje me nenin 22 të LPP-së, i cili numëron në mënyrë taksative dokumentet e përbarueshme dhe nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i cili përcakton se: “2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragraf i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.”, rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm”.

Ndërsa sa i përket Kontratës për Hipotekën LRP.nr. 561/2018 dhe Ref.nr. 362/2018 e datës 06.12.2018 e hartuar nga noteri Arësim Avdijaj e paraqitur në shkresa të lëndës në kopje të noterizuar pranë zyrës noteriale të Noterit Arësim Avdijaj e cila identifikohet me shenjën LRP-nr.rend:3525/2022 dhe Aktvendimit për regjistrimin e hipotekës Nr.117/22018/H, vlerëson se e njëjta i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbartues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjtat mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.DH.SH.II nr.1283/24 me datë 02.10.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**